



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja **a**, dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 22.03.2018 miratoi këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Lumnije (Musa) Latifi.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 10019-0, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë P-71914059-10019-0, e evidentuar si pasuri shoqërore , kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është: pjesa e parcelës kadastrale nr. 751-4, Zona kadastrale Matigan Prishtinë, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914059-00751-4, në pronësi të Lumnije (Musa) Latifi, me destinim rrugë e planifikuar.
- III.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV.** Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e planit rregullues urban. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe se kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronares së parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/02-70120/18, më 23.03.2018

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

